



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI

ZYRA E KRYETARIT

KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR'S OFFICE – BAŞKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjiçanit 01. nr. 16-126211 të datës 06.11.2014 dhe në zbatim të nenit 81 paragrafi 3 të Ligjit të Prokurimit Publik nr. 05/L-068 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 1 dt. 06 janar 2016) për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237) dhe pikës 61.15 të Rregullës dhe Udhëzuesit operativ për prokurimin publik 01.11.2016 dhe kontratës së punës nr.53/22 të dt. 06.10.2022 **“Furnizim me ujë të pijes” dhe “OE “ADEA GROUP”- SH.P.K, nga Gjiçani,” (në anën tjetër)(neni 1.1), Kryetari i Komunës nxjerrë këtë:**

V E N D I M

**Për emërimin e Menaxherit të Projektit dhe
Organit Mbikëqyrës**

1. Në detyrën e Menaxherit të Projektit për projektin: **“Furnizim me ujë të pijes” me numer të mbrendshëm i prkurimit: AQP 22 013 R 111 emëroi :**

z. Fatos Qerimi – Drejtor i DFSHP-së – Zyrtar për Furnizim Caktohet Menaxher për të gjitha institucionet Shkollore.

2. Menaxheri i projektit është i obliguar që, në suaza të funksioneve dhe përgjegjësi të tija, të :
 - a) Menaxhoi obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në Kontratë;
 - b) Sigurojë se Op. Ek. kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë;
 - c) Sigurojë që Op. Ek. i përmbushë të gjitha obligimet e performances apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - d) Sigurojë që Op. Ek. e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat e kontratës;
 - e) Sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbushë gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - f) Sigurojë se ka kontroll sdukatë të kostove, cilësisë dhe kohës aty ku është e përshtatshme;
 - g) Sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
 - h) Sigurojë që të gjitha rexhistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen siç kërkohet;
 - i) Nxjerrë variacione apo urdhëra për ndryshim nëse kërkohet , në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;

- j) Sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta merr miratimin;
 - k) Jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit;
 - l) Dorëzoj Raporte mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga Zyrtari Kryesor Administrativ;
 - m) Në pajtim me nenin 61.7 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, pas pranimit të Kontratës dhe para fillimit të zbatimit të Kontratës, Menaxheri i Projektit i Autoritetit Kontraktues në bashkëpunim me Menaxherin e Kontraktuesit, do të përgatis një Plan për menaxhimin e kontratës, duke përdorur Formularin Standard të aprovuar nga KRPP-ja. Brenda afatit optimal, jo më gjatë se dy ditë pune, Menaxheri i Projektit do ta përcjell një kopje të Planit për menaxhimin e kontratës Departamentit të Prokurimit. Pasi Zyrtari përgjegjës i Prokurimit pranon Planin për menxhim të Kontratës, Menaxheri i Projektit do ti lëshoi Op. Ek. – Kontraktuesit Letrën për fillimin e punëve.
 - n) kryen edhe punë tjera të nevojshme, sipas dokumentit të ofertës, kushteve të kontratës, përgjegjësi të përcaktuara si në Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës, pjesë përbërëse e Dosjes së tenderit.
3. Në pajtim me nenin 81 të LPP-së Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, në bazë të përgjegjësi dhe autorizimeve të tije ligjore, në çdo kohë mundë të monitoroi nëse kontrata është zbatuar dhe/ ose është duke u zbatuar në përputhje me kushtet e kontratës, duke u përkufizuar në fushveprimin dhe qëllimin e kontratës, Specifikacionin dhe përgjegjësitë e Autoritetit Kontraktues dhe Kontraktuesit, me të vetmin qëllim përkushtimin e palëve në kontratë për përmbushjen në mënyrë cilësore, sasiore dhe në kohë të kontratës, konform kushteve dhe termeve të kontratës.
4. Në detyrën e Organit Mbikqyrës për realizimin dhe mbikqyrjen e projektit : ‘Furnizim me ujë të pijes’ me numer te mbrendshëm i prkurimit: AQP 22 013 R 111 emëroi :

z. Agush Nuhiu – Zyrtar për Furnizim

5. Organi Mbikëqyrës është i obliguar që, në suaza të kompetencave dhe përgjegjësi të tij dhe duke u përkujdesur për ekzekutimin në kohë dhe në cilësi të kontratës, ti kryej këto punë dhe ti ndërmarrë këto aktivitete, si vijon :
- Të ndërmerr gjitha masat, procedurat dhe aktivitetet e punës dhe të mbikqyrjes, të nevojshme – domosdoshme, për të azhuruar , mundësuar dhe siguruar, në bashkëpunim me organet relevante komunale, që dispozitat e kontratës të përmbushen në kohë nga Kontraktuesi – Kryesi i Punëve dhe që të drejtat e Autoritetit Kontraktues të përcaktuara në kontratë dhe / ose që lidhen me kontratën të ushtrohen sipas kërkesave kontraktuale, për mbrojtjen e interesave të Autoritetit Kontraktues ;
 - Duke zbatuar në përpikëri dispozitat dhe rregullat e përcaktuara në Kontratë dhe Planin për Menaxhimin e Kontratës, do të bashkëpunoi ngusht me Kontraktuesin – Kryesin e Punëve, duke i shqyrtuar idetë dhe propozimet që mundë të ndikojnë drejtpërdrejtë në përmbushjen dhe realizimin me sukses dhe në kohë të detyrave që dalin nga Detyrat si në Specifikimin teknik të punëve, Kontratë, Kushtete të Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës, pjesë e dosjes së tenderit, me theks të vaçant rreth cilësisë së materialeve dhe punëve , menaxhimin e pagesave për punët / shërbimet e kryera dhe rishikimin e zbatimit të kontratës.
 - Të konfirmoi në Ditarin e Punës kryerjen e punëve, në baza ditore, konform klauzulave të Kontratës dhe Specifikimi Teknik të Dosjes së Tenderit;
 - Në bashkëpunim të plotë me Menaxherin e Projektit të Autoritetit Kontraktues të siguroi detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Drejtorisë Komunale për Prokurim duke marrë miratimin prej sajë;

- Në bashkëpunim të plotë me Menaxherin e Projektit të Autoritetit të Kontraktues të siguroi dhe ofroi detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Drejtorisë Komunale për Prokurim
 - në çdo kohë dhe / ose në kërkesë të tyre, do ta informoi Zyrtarin Kryesor Administrativ – Kryetarin e Komunës, Drejtorinë Komunale për Prokurim Publik dhe Drejtorin të Drejtorisë nga e cila vjen i/e emëruari/a, për ecurinë e realizimit të punimeve sipas Planit për Menaxhimin e Kontratës, pengesat dhe/ ose vështirësit eventuale, duke dorëzuar raporte mbi progresin ose përmbushjen e kontratës;
 - do të kryej edhe punë tjera të nevojshme, sipas dokumentit të ofertës, kushteve të kontratës, përgjegjësi të përcaktuara si në Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të Kontratës, pjesë përbërëse e Dosjes së tenderit.
6. Ky Vendim hyn në fuqi dhe zbatohet ditën e marjes ndërsa, për bazë do të ketë zbatimin me përpikmëri të kontratës mes Autoritetit Kontraktues – Komunës së Gjilan dhe Operatorit Ekonomik – Punëkryesit :O.E. “ADEA GROUP”- SH.P.K, nga Gjilani, ”/, sipas planit të përcaktuar dhe aprovuar nga organi kompetent.

Shtojcë : Kontrata nr. 53/22
Specifikimi i teknik

T'i dërgohet :
1 x menaxherit të projektit
1 x dosjes

Emëroi
Kryetari i Komunës

